

Analizë e shkurtër:

TRASHËGIMIA KULTURORE: NJË HISTORI E PATREGUAR

TRASHËGIMIA KULTURORE E KOSOVËS NË TEKSTET
MËSIMORE TË HISTORISË NË KOSOVË

Brief analysis:

CULTURAL HERITAGE: AN UNTOLD STORY

KOSOVO'S CULTURAL HERITAGE IN KOSOVO'S
HISTORY TEXTBOOKS

Kratka analiza:

KULTURNO NASLEĐE: NEISPRIČANA PRIČA

KULTURNO NASLEĐE KOSOVA U ŠKOLSKIM
UDŽBENICIMA ISTORIJE NA KOSOVU

Shkëlzen Gashi

Analizë e shkurtër:

TRASHËGIMIA KULTURORE: NJË HISTORI E PATREGUAR

TRASHËGIMIA KULTURORE E KOSOVËS NË TEKSTET
MËSIMORE TË HISTORISË NË KOSOVË

nga Shkëlzen Gashi



Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “EC për qytetë transparente dhe gjithëpërfshirëse”, i përkrahur finansiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur. Përbajtja dhe qëndrimet e shprehura në këtë publikim i përkasin autorëve dhe organizatës jo-qeveritare EC Ma Ndryshe.

Botues: EC Ma Ndryshe

Autor: Shkëlzen Gashi

Redaktimi gjuhësor: Gazmend Bërlajolli

Përkthimi në sérbisht: Anton Berishaj

Përkthimi në anglisht: Elizabeth Gowling

Dizajn dhe faqosje: Bubrrcat

Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, 10000/Prishtinë

www.ecmandryshe.org

info@ecmandryshe.org

038-224-967

029-222-771

PËRMBAJTJA

Hyrje	4
Pse duhet ta mësojmë trashëgiminë kulturore në shkolla?	4
Çka mësojmë për trashëgiminë kulturore?	4
Si mësohet Lidhja e Prizrenit?	4
Çka nuk mësojmë nga trashëgimia kulturore?	5
Rasti i "Trekëndëshit" në Prishtinë	6
Përfundim	6
Referencat	7
EC Ma Ndryshe	8

Hyrje

Kjo analizë e shkurtër synon t'i shqyrtojë tekstet mësimore të historisë për shkollat filllore dhe të mesme në Kosovë, të miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës, për të parë se si prezentohej në to trashëgimia kulturore e Kosovës. Çka paraqesin e çka jo këto tekste nga trashëgimia kulturore e Kosovës që prej antikitetit e këndej, me theks të veçantë gjatë kohës së sundimit mesjetar sérb, pastaj gjatë sundimit pesëshekullor osman dhe në fund gjatë sundimit sérb/jugosllav në pothuajse tërë shekullin e kaluar? Duke qenë analiza e shkurtër, do të përqendrohem i te prezantimi i Lidhjes së Prizrenit dhe te mosprezentimi i Përmendores së Vëllazërim-Bashkimit, e njohur si "Trekëndëshi".

Pse duhet ta mësojmë trashëgiminë kulturore në shkolla?

Trashëgimia kulturore duhet të mësohet në shkolla përsye të shumta. Ajo ndërlidhet me proceset e formësimit të identiteteve, prandaj edhe duhet t'u mësohet fëmijëve si burim i identitetit. Një tipar shumë i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore është edhe ndikimi që ajo ka në kultivimin e kujtesës kolektive. Si trashëgimia e prekshme, ashtu edhe ajo shpiftërore, janë përcues të narrativave të tjerë kaluarës dhe këto mësimë i ndihmojnë fëmijët në kultivimin e ndjenjës së përkatësisë. Mësimet mbi trashëgiminë dhe diversitetin kulturor duhet të janë pjesë e programeve shkollore për t'i edukuar brezat e rinx pa i ngarkuar me urrezitje, duke i angazhuar në pengimin e konflikteve dhe nxitjen e mirëkuptimit mes kulturave. Në të njëjtën kohë, veç përfitimeve sociale dhe kulturore, trashëgimia kulturore sjell edhe dobi ekonomike për shoqërinë, prandaj ndjenja përuajtjen dhe promovimin e trashëgimisë duhet të kultivohet te fëmijët sa më herët.

Çka mësojmë për trashëgiminë kulturore?

Në këto tekste paraqiten kryesisht objekte/monumente të trashëgimisë kulturore dhe atë vetëm përmes fotografive. Shumica dërrmuese e objekteve/monumenteve që prezantohej në to janë të karakterit etnik e politik, por edhe kur ky u mungon, sërisht prezantohej në kontekst etnik e politik. Në përgjithësi, interpretimet ndjekin një narrativë etnocentrike dhe janë në kundërshtim të plotë me praktikat e mira botërore mbi të mësuarit e trashëgimisë dhe të diversitetit kulturor në shkolla.

Për periudhën e antikitetit, objektet/lokajtjet e paraqitura në këto tekste (kryesisht përmes fotografive) janë: Kalaja e Shkupit, Ulipiana dhe Kështjella e Rozafatit. Pra, përvèç Ulipianës që gjendet në territorin e Kosovës, dy nga këto objekte gjenden jashtë saj: Kalaja e Shkupit në Maqedoni dhe Kështjella e Rozafatit në Shqipëri.

Sa i takon Kosovës në Mesjetë (sundimi bizantin, bullgar dhe ai serb) nuk prezantohej asgjë. Përashtim bën 'Historia 7', në të cilën figuron një fotografi e Patriarkanës së Pejës. Për periudhën prej Betejës së Kosovës (1389), që shënon fillimin e sundimit osman në Kosovë e deri te Lidhja e Prizrenit (1878), që nënkupton fillimin e përfundimit të këtij sundimi gati pesëshekullor, paraqiten vetëm Tyrbja e Sultan Muratit dhe Monumenti i Skënderbeut në Kruri, kurse në tekstin 'Historia 7' figuron edhe një fotografi e Xhamisë së Sulltan Mehmet Fatihut në Prishtinë. Sa i takon paraqitjes së monumenteve të ndërtuara gjatë sundimit pesëshekullor osman në Kosovë, përashtim bëjnë deri-diku vetëm tekstet 'Historia 11' dhe 'Historia 12' përgjimnazin e përgjithshëm.

Periudha e Rilindjes Kombëtare, e cila nis me Lidhjen e Prizrenit (1878) dhe përfundon me Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë (1912) paraqitet me këto objekte: Lidhja e Prizrenit, Lidhja e Pejës, Mësonjëtorja e Korçës dhe Shtëpia e Pavarësisë në Vlorë. Te shtjellimi i kësaj periudhe mbi tridekadëshe jepen edhe katër fotografi të tjera; njëra paraqet veshjet e grave gjatë kohës së Lidhjes së Prizrenit, tjetra veshjet kombëtare, dhe në dy të mbeturat e kësaj periudhe tregohen çuditërisht një imazh pazari drush dhe një tjetër dyqanesh të artizanateve.

Shekulli i kaluar, gjatë të cilit Kosova ishte kryesisht nën sundimin serb e jugosllav, me theks të veçantë periudha nën sundimin Jugosllavisë së Titos (1945-1990), përshtakuhet pjesërisht vetëm me disa të arritura në fushën e arsimit, siç janë Universiteti i Prishtinës dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve, si dhe në fushën e kulturës: letërsia, muzika, teatri e filmi, por nuk jepet asnjë e arritur në rrafshet e tjera.

Si mësohet Lidhja e Prizrenit?

Në tekstet mësimore të historisë të Kosovës thuhet se përfaqësuesit shqiptarë të të gjitha viseve, pa dallim feje, janë bashkuar në qershorr 1878 dhe kanë themeluar Lidhjen e Prizrenit, e cila ka organizuar ushtrinë e vet për t'i dëbuar pushtuesit dhe për ta formuar shtetin e pavarur shqiptar. Mirë-

po, në këtë fjali, e cila ngërthen thelbin e narrationit të teksteve të Kosovës për Lidhjen e Prizrenit, dalin disa probleme:

- **e para:** nuk është se janë mbledhë të gjithë përfaqësuesit e trojeve shqiptare, ngaqë shumica dërrmuese vinin nga Kosova e nga Malësia, kurse nga Shqipëria e Jugut ishin vetëm dy përfaqësues, njëri prej të cilëve Abdyl Frashëri;
- **e dyta:** vetëm pesë nga delegatët e mbledhur në Prizren ishin të krishterë, madje pika e fundit e dokumentit të parë të nxjerrë nga Lidhja e Prizrenit, i quajtur Kararname ose Akti i Vendimeve dhe i miratuar më 18 qershori 1878, thotë: ‘Ky dokument është nënshkruar nga 47 deputetë myslimanë (nënvizimi im), që të gjithë nga qytete të Shqipërisë Veriore e të Bosnjës’.
- **e treta:** dokumenti i Lidhjes së Prizrenit nuk thotë asgjë pér shkollat, pér bashkimin e trojeve shqiptare në një vilajet, pér autonominë, e aq më pak pér shtetin e pavarur shqiptar. Madje vetë Neni 1 i tij thotë se “...Lidhja e Prizrenit formohet me qëllim që të kundërshtojë çdo qeveri, përveç asaj të Portës së Lartë”, kurse Neni 2 sqaron se qëllimi i Lidhjes është me i mbrojtë “...të drejtat perandorake të personit të papërlyeshëm të madhërisë së Tij Sulltanit, sundimtarit tonë”.

Për më tej, ky dokument i referohet shariatit, çka nuk përmendet askund nëpër tekstet mësimore të historisë në Kosovë, ndërkqë në nenin e fundit të tij nënviron se “...lidhja do të kalojë brez pas brezi, tek fëmijët e fëmijëve tonë dhe ai që shkëputet prej saj do të konsiderohet ‘tradhtar i fesë islamë’ e do të mallkohet e përbuzet prej anës sonë”. Vetëm një vit pas themelimit të Lidhjes së Prizrenit, në një mbledhje që mbahet në Prizren, Lidhja pajtohet ta pranojë programin e autonomisë, kurse pas gati tre vjetësh, në një tubim të madh po në Prizren, Lidhja deklaron se do të angazhohet pér pavarësinë e plotë, çka edhe e përforcoi vendosmërinë e Perandorisë Osmane pér ta shtypur atë.

Në këtë tekste nuk prezantohen as grupet kundërshtuese politike gjatë periudhës së Lidhjes së Prizrenit, por përmendet vetëm “lëvizja kombëtare shqiptare”, gjë që lë të kuptohet se ka ekzistuar vetëm një forcë politike me njëfarë vazhdimësie historike që ka zhvilluar luftë të pandërrerë pér t'u çiruar nga pushtuesit osman. Mirépo, në vetë Lidhjen e Prizrenit kishin ekzistuar dy rryma: tradicionalistët myslimanë, të cilët dominonin, sidomos në Kosovë, si dhe intelektualët autonomistë, që simpatizoheshin kryesisht jashtë Kosovës.

Po ashtu, këto tekste nuk përmenden kurrfarë bashkëpunimi mes Lidhjes së Prizrenit dhe Qeverisë së Perandorisë Osmane, ndonëse në fillim pushteti osman kishte simpati të madhe pér Lidhjen e Prizrenit dhe nuk kishte krijuar kurrfarë pengesash pér formimin e saj, duke qenë se palët bashkërisht synonin t'i ruanin hapësirat që deri atëherë ishin nën sundimin e Perandorisë Osmane. Bashkëpunimi i Lidhjes së Prizrenit me Perandorinë Osmane merr fund pasi një grup i mllofusor shqiptarësh e vret në Gjakovë Mehmet Ali Pashën, i cili dërgohet nga Perandoria Osmane pér t'i bindë shqiptarët që t'i pranojnë vendimet e Kongresit të Berlinit pér ndryshimin e kufijve.

Çka nuk mësojmë nga trashëgimia kulturore?

Në shkollat e Kosovës fëmijët nuk e mësojnë asnjërin nga aspektet relevante të trashëgimisë kulturore që lidhen me: formësimin e identitetit, ndjenjën e përkatësisë, kujtesën kolektive, luftimin e urrejtjes, promovimin e mirëkuptimit mes kulturave, si dhe përfitimet ekonomike. Për më tej, atyre nuk u mësohet se trashëgimi kulturore nuk përbëjnë vetëm ndërtesat e objektet, pra vetëm pjesa materiale dhe fizike e të kaluarës.

Njëra nga kategoritë tejet të vlefshme dhe skajshmërisht të shpërfillura të trashëgimisë është ajo shpirtërorja. Nxënësit nuk mësojnë as pér teknikat dhe metodat e mbrojtjes e të promovimit të trashëgimisë kulturore, as nuk e shijojnë atë përmes vizitave në organizata, punës praktike në punëtoritë artizanale ose multimedias.

Sa i përket trashëgimisë kulturore materiale (të prekshme), siç janë objektet fetare, në këtë tekste nuk figurojnë objektet fetare mesjetare, kishat dhe manastiret ortodokse, të ndërtuara kryesisht gjatë sundimit mesjetar sërb, si pér shembull:

- Manastiri i Deçanit, i ndërtuar nga mesi i shek. 14 nga mbreti sërb Deçanski;
- Manastiri i Graçanicës, i ndërtuar nga mbreti sërb Milutin në vitin 1321;
- Kisha e Shën Premtes në Prizren, e ndërtuar me urdhër të mbretit sërb Milutin, në shek. 14;
- Patriarkana e Pejës, një kompleks manastiresh të ndërtuara në vitet 1266-1345.

Po ashtu, në shumicën dërrmuese të këtyre teksteve, duke përjashtuar tekstet ‘Historia 11’ dhe ‘Historia 12’ pér gjimnazin e përgjithshëm, nuk figuron asnjë nga objektit e ndërtuara kryesisht gjatë periudhës së sundimit gati

pesëshekullor osman, siç janë:

- objektet për ritet fetare: xhamitë, mesxhidet, tyrbet, teqet;
- objektet arsimore: medreset e bibliotekat;
- objektet e tjera: hamamet, urat e gurit, krojet publike, shtëpitë e banimit, kullat e sahatit, shatërvanet, hanet, çarshitë, e me radhë.

Është interesante se në këto tekste nuk figurojnë as lokaletë të rëndësishme si Janjeva, Binça, e Zymi. Pastaj, sa i takon trashëgimisë kulturore të periudhës socialiste, nuk jepet asnjë prej objekteve/monumenteve të ndërtuara gjatë kësaj periudhe, siç janë, mes tjerash:

- Monumenti i Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare (LANÇ), i ndërtuar në Prishtinë në vitin 1960, ku edhe janë të varrosur shumë luftëtarë të kësaj luftë;
- Përmendorja e Vëllazërim-Bashkimit, e njojur si "Trekëndëshi", që simbolizonte Vëllazërim-Bashkimin mes popujve në Kosovë, e ndërtuar në Prishtinë në vitin 1961;
- Monumenti i Gazimestanit në përkujtim të Betejës së Kosovës të vitit 1389, i ndërtuar në afërsi të Prishtinës në vitin 1953.

Lidhur me trashëgiminë kulturore jomateriale (shpirtërore), paraqiten përgjedhata dhe sipërfaqësish muzika, vallet, veshjet e artizanati, por nuk ka absolutisht asgjë për gjuhën, dialektet dhe nëndialektet e saj, standardizimin e gjuhës, për ushqimin, ritualet, e kështu me radhë. Sa i takon trashëgimisë kulturore natyrore nuk prezentohet asnjë bukuri natyrore me rëndësi historike e kulturore, madje asnjëra prej shtatë bukurive kryesore natyrore që kanë rëndësi historike e kulturore, si: Gryka e Rugovës, Shpella e Gadimes, Ujëvarat e Mirushes, Brezovica, Burimi i Drinit të Bardhë, Bifurkacioni i Nerodimes, Kanioni i Drinit të Bardhë.

Rasti i "Trekëndëshit" në Prishtinë

Njëri nga shembujt ilustrues të trashëgimisë kulturore që nuk mësohet në tekstet e historisë të Kosovës është Përmendorja e Vëllazërim-Bashkimit, e njojur si "Trekëndëshi", që simbolizonte vëllazërim-bashkimin mes popujve në Kosovë. Ky monument është ndërtuar në vitin 1961 ndërmjet dy objekteve të mëdha që sot janë Komuna e Prishtinës dhe Parlamenti i Kosovës, aty ku dikur ishte Çarshia e Prishtinës. Për nga stili artistik, monumenti është ndërtuar në fryshtë universale dhe përfaqëson një model tipik të veprave të artit publik të asaj kohe.

Pas luftës së vitit 1999, monumentit iu vu eksploziv, nga i cili u shkaktuan disa dëme të vogla, por që nuk u riparuan asnjëherë, madje që nga paslufta nuk ka pasur ndonjëherë as mirëmbajtje të tij. Për më shumë, po pas luftës së vitit 1999 janë artikular propozime për rrënimin e këtij monumenti dhe ndërtimin e një sheshi të ri. E vetmja ndërlidhje që i bëhet këtij monumentit është ajo me ideologjinë politike të kohës kur u ndërtua, duke anashkaluar tërësisht tiparet artistike dhe vlerat sociale të tij. Kjo edhe është arsyeja kryesore pse nuk prezentohet ky monument që përbën një kategori të veçantë të trashëgimisë kulturore në Kosovë. Ndonjëse dikur "Trekëndëshi" gjëzonë statusin e monumentit, ai sot nuk gjendet as në Listën e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës.

Përfundim

Nga shqyrtimi i teksteve mësimore të historisë në Kosovë del se trashëgimia kulturore në këto tekste prezentohet në mënyrë tejet të kufizuar. Nuk thuhet asgjë mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe lidhjen e saj me formimin e identiteteve, as për ndikimin që diversiteti kulturor mund të ketë në zhvillimin e tolerancës, pengimin e urrejtjes, të racizmit dhe formave të tjera të diskriminimit që mund të shkaktojnë konflikte. Këto tekste nuk e shpjegojnë fare konceptin e "trashëgimisë kulturore", e madje as që e përmendin ndokund. Tekstet paraqesin kryesisht objekte/monumente të trashëgimisë kulturore dhe këto pothuajse kryekëput përmes fotografive. Shumica dërrmuese e objekteve/monumenteve të prezantuara në këto tekste kanë karakter etnik e politik, por edhe kur nuk e kanë, prezentohen sërisht në kontekst etnik e politik. Në këto tekste nuk prezentohet fare sundimi sërb gjatë mesjetës në Kosovë, e për rrjedhojë mungon edhe prezentimi i trashëgimisë kulturore, kryesisht i objekteve fetare, të kësaj periudhe. Po ashtu, duke pasë parasysh se në këto tekste periudha pesëshekullore nën sundimin osman paraqitet si e errët, nuk figuron pothuajse asgjë nga trashëgimia kulturore e saj. Përashtim bëjnë deri-diku vetëm tekstet 'Historia 11' dhe 'Historia 12' për gjimnazin e përgjithshëm. Sa i takon periudhës nën sundimin Jugosllavisë së Titos (1945-1990), jepen pjesërisht vetëm disa të arritura në fushën e arsimit e të kulturës, por nuk figuron asnjëri prej objekteve/monumenteve të ndërtuara gjatë saj. Kosova po synon anëtarësimin në UNESCO, ndërkohë që në tekstet mësimore të historisë brezave të rinj nuk po u mësohet pothuajse asgjë nga trashëgimia kulturore e saj.

Referencat

Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj. Historia 5. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013.

Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj. Historia 6. Prishtinë: Libri Shkollor, 2009.

Isa Bicaj dhe Arbër Salihu. Historia 7. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013.

Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj. Historia 9. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013.

Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj. Historia 10. Prishtinë: Libri Shkollor, 2011.

Jusuf Bajraktari dhe Isa Bicaj. Historia 11 gjimnazi i përgjithshëm. Prishtinë: Libri Shkollor, 2006.

Isa Bicaj dhe Isuf Ahmeti. Historia 12 gjimnazi shoqor. Prishtinë: Libri Shkollor, 2012.

Jusuf Bajraktari dhe Arbër Salihu. Historia 12 gjimnazi i përgjithshëm. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013.

Isa Bicaj dhe Isuf Ahmeti. Historia 13. Prishtinë: Libri Shkollor, 2006.

EC Ma Ndryshe

EC është organizatë e komunitetit, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për avansimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë. Organizata punon me një numër të konsiderueshëm grupesh të komunitetit, si dhe mirëmban një presion të përhershëm ndaj qeverive lokale për qeverisje gjithëpërfshirëse, transparente dhe llogaridhënëse. EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë. Nga janari i vitit 2015, EC funksionon me këto tri programe: Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit), Qeverisja e mirë (monitorim dhe avokim), Hulumtimi (prodhim i dijes)

Tiparet dalluese të EC janë: një, fokusi gjeografik, dhe dy, qasja ndaj çështjeve të interesit. E bazuar në Prizren dhe Prishtinë, organizata përdor qasje antropologjike në hulumtimin dhe zhvillimin e politikave. Si rezultat, produktet e hulumtimit të organizatës ofrojnë përbajtje të besueshme, pasi që merren me thelbin e problemit në vend se me simptomat. Për më tepër, EC mbulon fusha të veçanta sikur planifikimi urban, politikat kulturnore, menaxhimi i hapësirës publike dhe të ngjashme, të cilat janë përgjithësisht të nënrajtua në Kosovë. Aktiviteti hulumtues dhe aktivizmi grassrootsi organizatës janë metoda pune të kombinuara mirë dhe të ndërvura. Përmes aktivizmit, EC angazhohet në mënyrë të përhershme në punë me grupet e komunitetit për t'i identifikuar nevojat e tyre, të cilat janë burime që e ushqojnë komponentën e hulumtimeve. Kjo metodologji mundëson ndikim më të madh tek agjenda e politikëbërjes, pasi që idetë vijnë nga poshtë, ndërsa paralelisht krijohen mundësi për përfshirjen e politikëbërësve në

një debat konstruktiv dhe të mirëinformuar.

Projektet kryesore të organizatës gjatë viteve të fundit: EC për qytete transparente dhe gjithëpërfshirëse (2015 –2016), Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale (2015–2016), Urbanizmi I Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013–2016), Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren (2014–2015), Qyteti Gjithëpërfshirës, planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013–2015), Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë (2014–2016), Zhvillimi rajonal përmes turizmit kulturor (2014–2015), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale (2013–2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore e zhvillimit lokal dhe rajonal në Prizren (2013–2015), Pjesëmarrja publike në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2012 –2013), Transparenca Online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2012–2015), Një tregim ballkanik (2011–2012), Aktivizmi qytetar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (2009–2010)

Publikimet e fundit të organizatës: Milionat e shpenzuara për monumentet e mbyllura (2016), Një qytet për komunitetin (2015), Katalogu i Rajonit Jug “Bukur dhe Gjelbër” (2015, Zhdukja e Gjurmëve – Qendrat historike të Kosovës (2015), Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore (kontribut për raportin e Progresit) (2015), (Pa)drejtësia në urbanizmin e Prizrenit (2015), Grupet e komunitetit dhe planifikimi urban në Prizren (2015), Katalogu i Rajonit të Prizrenit (2015), Planifikim urban për qytetarët (2014), Qendra Historike e Prishtinës numëron ditët e fundit (2014), Ku është kall-drämi i Prizrenit? (2014), Paraja publike si “paret e babës” (2014), Udhëzues për transparencën në komuna (2014), Ligjet nuk po e mbrojnë Qendrën Historike të Prizrenit (2014), Urbanizmi si lexim i qytetit (2014).



Brief analysis:

CULTURAL HERITAGE: AN UNTOLD STORY

KOSOVO'S CULTURAL HERITAGE IN KOSOVO'S HISTORY TEXTBOOKS

by Shkëlzen Gashi



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

This report was prepared as part of the ‘EC for transparent and inclusive cities’ project, with financial support from the Kosovo Foundation for Open Society. The contents and opinions expressed in this publication are those of the author and EC Ma Ndryshe NGO.

Published by EC Ma Ndryshe

Written by Shkëlzen Gashi

Edited by Gazmend Bërlajoli

Translated into Serbian by Anton Berishaj

Translated into English by Elizabeth Gowing

Design and layout by Bubrrecat

Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, 10000/Prishtinë

www.ecmandryshe.org

info@ecmandryshe.org

038-224-967

029-222-771

CONTENTS

Introduction	14
Why should cultural heritage be taught in schools	14
What is taught about cultural heritage?	14
How is the League of Prizren taught?	14
What is not taught about cultural heritage?	15
The case of the 'Triangle' monument in Prishtina	16
Conclusion	16
References	17
EC Ma Ndryshe	18

Introduction

This short analysis aims to review Kosovo's primary and middle school history text books, as approved by the Republic of Kosovo's Ministry of Education, Science and Technology, in order to see how Kosovo's cultural heritage is presented. What do these textbooks include, and what do they leave out, of Kosovo's cultural heritage from ancient times onwards, with a particular emphasis on medieval Serbian rule, the five centuries of Ottoman rule and finally the Serbian/ Yugoslav rule for almost all of the last century? As a short analysis we will focus on the presentation of the League of Prizren and the absence of the Brotherhood and Unity Monument known as the 'Triangle'.

Why should we teach cultural heritage in schools?

Cultural heritage should be taught in schools for many reasons. It is connected with the process of identity forming, and thus should be taught to children as a source of identity. A very important feature of cultural heritage is also the impact it has on the cultivation of collective memory. Both tangible and intangible heritage is a channel for the narratives of the past and learning these helps children to cultivate a feeling of belonging. Learning about cultural heritage and diversity should be part of school curricula in order to educate the younger generation without burdening them with hatred, to engage them in prevention of conflict and encourage understanding between cultures. At the same time, as well as the social and cultural benefits, cultural heritage offers economic benefit for society and thus an instinct for the protection and promotion of heritage should be cultivated in children as early as possible.

What do we teach about cultural heritage?

In these textbooks it is mainly cultural heritage sites and monuments that are described and these only through photographs. The vast majority of sites and monuments which are presented are of an ethnic and political nature, but even when this is lacking, they are still presented in an ethnic and political context. In general, interpretations follow an ethnocentric narrative and are wholly in conflict with good practice worldwide on the teaching of cultural heritage and cultural diversity in schools.

For the period of antiquity, the sites/ locations presented in the textbooks (mainly through photographs) are the Skopje citadel, Ulpiana and the Rozafa castle. Thus two of the sites are out of the country: the Skopje citadel in Macedonia and the Rozafa castle in Albania while Ulpiana is located within the territory of Kosovo.

There is no presentation at all of medieval Kosovo (Byzantine, Bulgarian and Serbian rule). The exception to this is Historia 7 which features a photograph of the Patriarchate of Peja/ Peć. For the period from the Battle of Kosovo (1389) which marks the beginning of Ottoman rule in Kosovo, and up to the League of Prizren (1878) – i.e. the beginning and end of this almost five centuries of rule – the only thing included is the Turbe of Sultan Murat and the Monument of Skanderbeg in Kruja, while the textbook History 7 also features a photograph of the Sultan Mehmet Fatih Mosque in Prishtina. As for the presentation of the monuments built during the five centuries of Ottoman rule in Kosovo, there is a small exception made only in the History 11 and History 12 textbooks for general high school.

The period of the National Renaissance which began with the League of Prizren (1878) and ended with the Declaration of Albanian Independence (1912) is represented through the following sites: the League of Prizren, the League of Peja, the school in Korça and the House of Independence in Vlora. The coverage of this thirty year period includes four other photographs: one shows women's costume during the time of the League of Prizren, another shows national costume, and the remaining two for this period rather strangely show an image of a wood market and artisan shops.

The last century, during which Kosovo was mainly under Serbian and Yugoslav rule, and in particular the period under the rule of Tito's Yugoslavia (1945-1990) is partially described only with some achievements in the field of education, such as the University of Prishtina and the Academy of Arts and Sciences, and the field of culture: literature, music, theatre and film, but no achievement is mentioned in other fields.

How is the League of Prizren taught?

In the history textbooks of Kosovo it is said that the Albanian representatives of all regions, irrespective of religion, came together in June 1878 and formed the League of Prizren, which organised its own army to expel those in power

and form an independent Albanian state. However, various problems arise from this sentence, which represents the heart of the narrative of the Kosovo textbooks on the League of Prizren:

- the first is that not all representatives of Albanian regions came together, since the vast majority came from Kosovo and the highlands, while there were only two representatives from southern Albania, of whom one was Abdyl Frashëri;
- the second is that only five of the delegates gathered in Prizren were Christian, and in fact the final point of the first document issued by the League of Prizren, called Kararname or the Act of Decisions, approved on 18 June 1878 says 'This document is signed by 47 Muslim representatives [my emphasis] of the cities of Northern Albania and Bosnia'.
- thirdly, the League of Prizren document says nothing about schools, about the union of Albanian lands into one vilayet, or about autonomy, and even less about an independent Albanian state. In fact its first article says that '...the League of Prizren is formed with the aim of opposing any government other than that of the Sublime Porte' while Article 2 clarifies that the aim of the League is to protect '... the imperial rights of the unassailable person of his majesty the Sultan, our ruler'.

Furthermore, this document refers to Sharia, which is mentioned nowhere in the history textbooks of Kosovo, and meanwhile in its final article it emphasises that '... the league will continue, generation after generation, to our children's children and he who breaks away from it will be considered a "traitor to the Islamic faith" and will be cursed and scorned by us'. Just one year after the League of Prizren was established, the League agreed, at a meeting held in Prizren, to accept the programme of autonomy, while nearly three years later, in a great meeting also in Prizren, the League declared that it would work for full independence, which also strengthened the resolve of the Ottoman Empire to repress it.

In these textbooks there is also no mention of the groups of political opposition during the period of the League of Prizren, with references only to 'the national Albanian movement', which leads it to be understood that there existed only one political force with some kind of historical continuity which carried on an uninterrupted war for liberation from Ottoman conquerors. However, within the League of Prizren itself there were two schools of thought: the Muslim traditionalists, who dominated, especially in

Kosovo, and the autonomist intellectuals, whose sympathisers were mainly outside Kosovo.

Likewise, these textbooks make no mention of the collaboration between the League of Prizren and the government of the Ottoman Empire even though at the beginning the Ottoman powers had great sympathy with the League of Prizren and offered no impediment to its formation, since those involved both aimed to protect the area which had been until then under the rule of the Ottoman Empire. Collaboration between the League of Prizren and the Ottoman Empire ended when a group of enraged Albanians in Gjakova killed Mehmet Ali Pasha who had been sent by the Ottoman Empire to persuade the Albanians to accept the decisions of the Congress of Berlin on border changes.

What is not learned from cultural heritage?

In Kosovo's schools children learn none of the relevant elements of cultural heritage which are related to the formation of identity, the feeling of belonging, collective memory, tackling hatred, promotion of understanding between cultures and economic benefits. Furthermore, they are not taught that cultural heritage is not made up solely of buildings and sites, of just parts of the physical material of the past.

One of the most valuable, and highly neglected, categories of heritage is the intangible. Pupils do not learn about techniques and methods for protecting and promoting cultural heritage and nor do they experience it through visits to organisations, practical work in craft workshops or multimedia.

As for material (tangible) cultural heritage, such as religious sites, these textbooks feature no medieval religious sites, such as the Orthodox churches and monasteries, mainly built during medieval Serbian rule, with examples like:

- Dečani monastery built from the middle of the fourteenth century by the Serbian king Dečanski;
- Gračanica monastery, built by the Serbian king Milutin in 1321;
- the church of Saint Prenda in Prizren, built on the orders of the Serbian king Milutin in the fourteenth century;
- the Patriarchate of Peć, a complex of monasteries built from 1266 to 1345.

Likewise, in the vast majority of these textbooks, with the exception of History 11 and History 12 for general high

school, there is no mention of the buildings constructed mainly during the five centuries of Ottoman rule such as:

- buildings for religious ceremonies: mosques, turbes, teques;
- educational buildings: madrasas and libraries;
